



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 7

Rrogozhinë, më 15.07.2025 ora 10 : 00⁰⁰

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.


Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën Nr.2811.Prot datë 09.07.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.06.2025.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5-Miratim i projekt - vendimit, Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi “Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025”
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë”.
- 7- Shqyrtim i shkresës së ardhur nga Drejtoria e Financës.
- 8-Shqyrtim i informacionit të ardhur nga drejtoria e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik.
- 9-Të ndryshme.
 - Kërkesë nga poeti z.Hekuran Dedej

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Lorena Baku, Saimir Cani, Lije Dedej, Indrit Dedej, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari, Silvana Aliu, Fatmira Thartori, Shpati Kolgega.



Mungojnë :

Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
11. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : 11 Këshilltarë, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Znj. Silvana Aliu i bashkohet mbledhjes në min e 5 të zhvillimit të saj, znj. Fatmira Thartori i bashkohet mbledhjes në min e 8 të zhvillimit të saj, z. Shpati Kolgega i bashkohet mbledhjes në minutën e 35 të zhvillimit të saj, duke e çuar në 14 numrin e këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Erind Tosku, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj. Gezime Met-hasani, znj. Lorena Baku, z. Saimir Cani, znj. Lije Dedej, z. Indrit Dedej, z. Hekuran Xhani dhe Mukades Gixhari. Jemi gjithsej 11- Këshilltarë.



-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 23.06.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 19 . Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të z. Isa Halili.

Vendim nr . 20 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 21 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 22 . Për emërtimin e disa shesheve, rrugëve dhe bulevardeve në qytetin Rrogozhinë.

Vendim nr . 23 . Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë

-Kalojmë në pikën e parë. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.06.2025. E keni të gjithë përpara e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian.

Ledian Hasani . Kemi 17- familje përfituese dhe fondi është 65 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës për fondin bllok 6% ? z. Lulzim?

Lulzim Hasa . Jo, asgjë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje diskutim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.24. Miratohet me 11 vota pro, projekt - vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2802.Prot datë 09.07.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2802/1.Prot datë 09.07.2025.

Mukades Gixhari . Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian.

Ledian Hasani . Janë 13-familje përfituese dhe fondi është 66 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje sugjerim. Po z. Indrit Dedeji.

Indrit Dedej . A mund të kalohet dhe muaji Gusht?

Ledian Hasani . Jo nuk e kaloj dot sepse duhet të shikojmë kush fiton kush del përfitues nuk e bëjmë dot. Minimumi ne më të paktën presim datën 10, mund ta bëjmë me datë 11 ose 12 mund ta bëjmë Gusht.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet. Kalojmë në pikën 5. Miratim i projekt - vendimit, Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi “Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025”. Vazhdojmë po me z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Siç e keni në projektvendim në total janë 8-përfitues , ne kuota të lira kemi 23 kuota i bie që janë dhe 15 kuota të lira për vitin 2025. Aplikantët janë të gjithë të pastrehë nuk kanë shtëpi nuk kanë banesë të gjithë aplikantët të tetë që janë këtu.

Erind Tosku . Çfarë afati kohor kanë?

Ledian Hasani . Deri në Dhjetor edhe mund ta shtyjmë.

Erind Tosku . Se mbase disa persona nuk janë informuar.



Ledian Hasani . Jo, kemi bërë shpallje dy herë tek faqja e bashkisë.

Erind Tosku . Mbledhja e këshillit bashkiak mund të ndikojë që kemi akoma kuota të lira 15. Deri në Dhjetor...

Ledian Hasani . Deri në Dhjetor është pjesa dokumentacionit që mund ti vonojë pak në bankë.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua dhe këshilltarja Silvana Aliu.

Indrit Dedej . Për listën e dytë ka sjellë Ledi komisioni i ekonomisë nuk e kaloi.

Ledian Hasani . Pa problem, ju votoni kundër vetëm do ma arsyetosh vendimin kush është arsyeja që edhe unë të marr hapa tjerë pastaj sepsenjerëzit kanë aplikuar online, kanë sjellë dokumentacionin që kanë dalë përfitues dhe unë jam i detyruar me e sjellë në këshill këtë listë.

Indrit Dedej . Me çfarë vërejta unë nga pikëzimi nuk plotësonin për mua asnjë...

Ledian Hasani . Ato janë të pastrehë të gjithë janë pa banesë, kjo është kryesorja që ato u kualifikuan direkt. Në moment që ato janë të pastrehë pa shtëpi ato kualifikohen.

Indrit Dedej . Unë nuk dua të veçoj emra unë e kam ndjekur dhe programin e pikëzimit , listën e parë e kaluam kurse listën e dytë unë nuk jam dakord sepse këto nuk plotësojnë asnjë kriter mund të lexoni kriteret aty dhe në qoftë se ato e meritojnë unë jam dakord.

Ledian Hasani . Atëherë më gjej një që ka shtëpi, nga këto 8 persona një person nga këto që ka banesë.

Silvana Aliu . Unë ndaj vajzën time që banon në një banesë me mua quhet e pastrehë.

Ledian Hasani . Kush të tha që të mos e ndash, kush të tha që të mos aplikojë vajza jote.

Silvana Aliu . Meqë kryetarja e grupit të pozitës ...

Ledian Hasani . Të gjithë të aplikojnë kanë të drejtën e Zotit pastaj se sa pikë marrin është komisioni që i vlerëson.

Indrit Dedej . Ti i vlerëson për vete ne iu vlerësojmë...



Ledian Hasani . Jo për vete jo, unë i vlerësoj në bazë të rregullave.

Silvana Aliu . Çdo ministri hapi aplikimin për kreditë e buta për çdo punonjës, si ka mundësi që disa punonjës nuk e kanë fituar dhe e kanë fituar tek ...

Alime Hoxha . Ministria e Arsimit ka hapur aplikimin për përfitimin e kredisë me interes 0 për mësuesit që janë kryefamiljarë që plotësojnë ca kritere këto janë bërë të gjitha me përzgjedhje nga ministria nuk ka lidhje fare gjithë aplikimi bëhet online, përgjigja jepet nga ministria nuk është ...

Silvana Aliu . E kuptoj që nuk është por si ka mundësi që nuk e përfituar...?

Ledian Hasani . Sepse atje ka shumë aplikantë.

Alime Hoxha . Sepse tek Ministria e Arsimit duhet të jesh me kontratë definitive i punësuar në arsim këto nuk janë të arsimit.

Silvana Aliu . Shihe mirë listën.

Alime Hoxha . Po këto nuk janë të arsimit.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltarja znj. Fatmira Thartori rreth minutës së 8 të zhvillimit të mbledhjes.


Silvana Aliu . Shihe mirë listën.

Ledian Hasani . Po çfarë lidhje ka ajo mund të ketë aplikuar dhe atje dhe nuk ka dalë përfituese, sepse këtu ka shumë kuota të lira.

Silvana Aliu . Ti je zyra ku këto aplikojnë se janë pa banesë apo je për ndihma sociale për personat në nevojë.

Ledian Hasani . Aty është drejtoria që i përfshin të gjithë strehim pa banesë të paaftë ndihmë ekonomike.

Silvana Aliu . Dhe një person që e ka rrogën 1 milion lekë ...



Ledian Hasani . Më mirë akoma sepse ai ka mundësi që ta shlyejë bankën. Në momnet që ai lidh një kontratë me bankën ai e shlyen, njëri që nuk ka të ardhura fare nuk ja jep banka.

Indrit Dedej . Unë nuk jam dakord për listën e dytë.

Ledian Hasani . Shiko ju e votoni kundër por unë dua arsyetim për këtë, në qoftë se ju doni të ngreni komision për të verifikuar veprimtarinë time që sot nuk e kam problem fare.

Indrit Dedej . Komisioni jot është komisioni jot.

Ledian Hasani . Është i bashkisë jo i imi.

Indrit Dedej . Ai vlerësimi që keni bërë ju ne nuk na mbush mendjen.

Ledian Hasani . Atëherë gjithsej janë 10 aplikantë , 2 aplikantë...

Silvana Aliu . Të ngrejmë një grup komision dhe e bëjmë muajin tjetër...

Ledian Hasani . Kur të doni... jo po vonohen ato , ne themi hajde ta hapim dhe njëherë se kemi 15 kuota të lira meqë janë të pastrehë.

Silvana Aliu . E kupton ti çfarë drejtorie je ? -Je për shtresat në nevojë nuk je që unë paskam 1 milion lekë .

Ledian Hasani . Ai që nuk ka të ardhura që i ka zero të ardhura në moment që shkon tek banka nuk e shlyen dot interesin e kredisë nëse do hedhin 100 mijë lekë ose 150 mijë lekë se kam idenë sa është interesi nuk ka mundësi ta shlyej edhe atij nuk ja jep banka pastaj , kjo është kredi me interes nuk është që po i ble shteti shtëpia. Shtëpinë e ble qytetari por nuk do e ketë me interes 10%-12% sa e ka banka por e ka 3% ky është favor i bën shteti.

Silvana Aliu . Po por nuk është zyra jote që duhet të mendojë për këtë gjë.

Ledian Hasani . Po kush zyrë duhet të jetë.

Silvana Aliu . Nuk janë shtresat në nevojë.

Indrit Dedej . O drejtor tek udhëzimi i pikëzimit me 300 mijë lekë rrogë në privat përfiton.



Ledian Hasani . Tek sistemi i pikëzimit janë përfshirë të gjithë shtresat në nevojë, kush do mund të vinte të aplikonte ne nuk kemi penguar njeri shpallja është bërë.

Silvana Aliu . Një person me rrogën 1 milion lekë i bie që është person në nevojë?

Ledian Hasani . Çfarë lidhje ka në qoftë se ajo nuk ka shtëpi? Atëherë një nga kriteret që ti i ke votuar vetë në këshill tek kriteret ekonomike kemi favorizuar që ato që i kanë të ardhurat mbi 100% të normales këto kanë 10 pikë dmth një familje që ka të ardhura më të larta favorizohet më tepër sepse ajo ka më shumë mundësi që ta shlyejë kredinë.

Silvana Aliu . Po flasim për listën e parë ishin të gjithë emra...

Ledian Hasani . Nuk ka lidhje lista sistemi i pikëzimit që keni votuar ju vetë familjet që kanë të ardhura të larta favorizhen më tepër sepse aty bazohen në VKM. Apliko kush ka thënë mos me aplikuar të gjithë të aplikojnë, kë kemi penguar. I kam njoftuar dhe vetë kush do të aplikojë të vijë të aplikojë.

Indrit Dedej . Nëse ti i ke bashkëngjit unë them lista e parë ne e kalojmë listën e dytë ...

Ledian Hasani . Lista parë është bërë me shtëpi, kanë blerë shtëpi, kanë ikur ato e kanë mbyllur.

Indrit Dedej . Ok, lista dytë unë nuk jam dakord.

Ledian Hasani . Atëherë në moment që më refuzoni e dua me arsyetim.

Indrit Dedej . Ore unë nuk jap llogari fare për arsyetim.

Ledian Hasani . Vendimin që do marrësh do arsyetosh diçka se...

Indrit Dedej . Tani kryeare e këshilli ne, unë nuk jam dakord.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër në lidhje me këtë pikë? Z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Një pyetje për drejtorin që edhe mos dalim nga tema. Për të kuptuar pjesën e aplikimit nuk është përcaktuar që është vetëm për shtresat në nevojë?

Ledian Hasani . Për të gjithë shtresa Ver.



Enver Memolla . Më lër ta mbaroj llogjikën. Që do të thotë nga minimumi që mund të ketë zero të ardhura deri me të ardhura të plota ka të drejtë secili të aplikojë.

Ledian Hasani . Që të gjithë në moment që ai më sjell dokumentacionin që nuk ka banesë jam i detyruar ta pranoj.

Enver Memolla . Nuk po mbaja mend kur ka ardhur miratimi i kriterëve prandaj thashë.

Ledian Hasani . Kriteret kanë ardhur nga Shkurti diçka e tillë.

Alime Hoxha . Janë miratuar nga Shkurti kriteret për këtë?

Ledian Hasani . Prit se jua them unë vendimin e këshillit bashkiak me datë 23.12.2024.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër diskutim?

Erind Tosku . Nëse keni ndonjë problem tek pjesa e personave që mund të mendoni që kanë në dokumentacion drejtoria ngreni komision verifikimi të mbajnë përgjegjësi ...

Ledian Hasani . Unë nuk kam luajtur mendsh ti jap kredi dikujt që ka shtëpi, unë për vete kam kontrolle tjera përveç asaj ...

Enver Memolla . Pyetjet që i bëra Ledios do të thotë që është e pranueshme sipas ligjit sepse përgjegjësinë e ka vetë personi. Ka kuota të lira?

Ledian Hasani . Ka 15, më thoni nëse ka njerëz që janë të interesuar.

Enver Memolla . Nga ana ligjore do hapet për riaplikim që nëse dikush nga ne që jemi anëtarë këshilli përfaqësues të popullit dhe dikush që nuk ka marrë njoftim nga njoftimi online, ka mundësi ti çohet njoftimi që të aplikojnë.

Ledian Hasani . Atëherë dy njoftimet që janë hapur përveçse ty të kam marrë personalisht ...

Enver Memolla . Nëse ka njerëz që nuk kanë informacion të vijnë ...

Ledian Hasani . I hapim por duhet t'i bëjmë ...



Enver Memolla . Me vendim këshilli?

Ledian Hasani . Fituesit normal në këshill do vijnë ato që janë fitues por kohën do ta bëjmë pak më të shpejtë se herët e tjera sepse deri në Dhjetor kur kërkon banka dokumentacionin është pak kohë e shkurtër . I hapim që sot po të doni bëjmë shpalljen që sotpo të doni ju dhe fillojmë.

Enver Memolla . Sa kuota janë?

Ledian Hasani . 15. Përveç këtyre të tetëve janë dhe 15 tjera total 23.

Erind Tosku . Atëherë mund t'i miratojmë të dyja njëkohësisht?

Ledian Hasani . Jo kjo ka mbaruar si procedurë, praktika e kësaj ka mbaruar.

Fatmira Thartori . Përderisa Ledi thotë që procedura është e hapur, mund të rihapet ne i kalojmë këto edhe prap ka 15 të lira.

Ledian Hasani . Është bërë shpallja që kanë palikuar 10 veta... Tani ne kemi mundësi të ndihmojmë njerëzit. Unë shikoj pjesën tek kriteret e strehimit këto personaasnjëri nga këto nuk më rezulton që të ketë banesë.

Indrit Dedej . Mos më ler të flas t'i ndaj tek e tek o Led nuk shkon.

Ledian Hasani . Unë jam në certifikatë me babën tim por baba nesër më thotë ik dil nga shtëpia.

Indrit Dedej . Unë jam për shtresat në nevojë nuk jam unë për ... nga kërkesa e këtyre që ke bërë ti nuk fiton asnjë.

Silvana Aliu . Njëri me biznes e me të gjitha qenka shtresë në nevojë.

Ledian Hasani . Kush është ai me biznes, shumë mirë.

Silvana Aliu . Ai mund të marrë kredi normale siç kam marrë unë siç ka marrë tjetri e tjetri.

Alime Hoxha . Tani ne po merremi me individët personalisht ka të ardhura ka shtëpi apo nuk ka shtëpi. Atë siç e tha Ledi përgjegjësinë ligjore për kriteret e mbajnë ata si i kanë përzgjedhur shumën e lekëve këto do ta marrin vetë do ta paguajnë vetë me atë interes që kanë 3 %. Tani ka



qenë i hapur aplikimi për të gjithë personat që kanë dashur me aplikuarqoftë për shtresat në nevojë qoftë për...

Ledian Hasani . Për të gjithë nuk përjashtohet asnjë qytetarë nga kjo asnjë, dmth asnjë qytetar që nuk ka banesë.

Silvana Aliu . Hidhe në votim.

Alime Hoxha . Ja ta mbaroj unë dhe e hedhim në votim pastaj. Ne kemi 23 kuota dhe sa aplikime ishin Ledio?

Ledian Hasani . 10.

Alime Hoxha . 10 aplikime dhe nga këta 10 tetë kanë fituar. Thjeshtë na e thuaj përse nuk kanë fituar ato dy?

Ledian Hasani . Jo se nuk kanë fituar , janë dy aplikantë që ato nuk mund ta vazhdonin dot më tej sepse kishin edhe kredi tjetër dhe e kishin të pamundur që ta përballonin i kam marrë mbi 10 herë në telefon ato dy persona janë tërhequr vetë. Ato nuk kanë sjellë dokumentacionin që nuk kishin banesë.

Alime Hoxha . Dhe e këta që duhet të përfitojnë patjetër duhet të kenë banesën?

Ledian Hasani . Atëherë në moment që ne e mbyllim listën në këshill votohet, lista dërgohet në bankë, banka i merr në telefon i njofton që jeni përfitues nga ky program.

Alime Hoxha . Cilat banka?

Ledian Hasani . Është BKT, Intesa Sanpaolo Bank, Raiffeisen Bank. Dy banka janë në Kavajë njëra është këtu, shumica e 8 personave kanë shkuar tek BKT. Të tetë ata janë bërë me shtëpi mesa kam dijeni unë.

Alime Hoxha . Shkojnë me dëshirë tek BKT?

Ledian Hasani . Shkojnë me dëshirë se e kanë më afër edhe banka tani kërkon që personi t'i çojë një certifikatë pronësie të blerësit kujt do ja blejë banesën. Banka e merre certifikatën e



pronësisë e mban aty kolateral personi që do shesë shtëpinë merr lekët nga banka kurse qytetaj paguan këstet deri kur ta likuideojë pas 20 vitesh.

Alime Hoxha . Përderisa nuk ka një kufi që janë shtresat në nevojë apo janë persona që paguajnë kredi mund të aplikojë kushdo për mua hidheni në votim .

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër nuk ka. Atëherë e hedhim në votim. Pro?

Indrit Dedej . 2, 3, 4, 5, 6, 7 nuk kalon.

Mukades Gixhari . Atëherë nuk miratohet.

-Me 8 (tetë) vota pro dhe 5 (pesë) kundër nuk miratohet pika 5 (pesë) e rendit të ditës, projektvendimi, Për vlerësimin e aplikantëve për përfitim nga programi "Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025".

Indrit Dedej . Kryetare ishim për një mbledhje jashtë radhe për gjithë atë katastrofë që është bërë

Mukades Gixhari . Kjo mbledhje është vendosur që në mbledhjen e kaluar.

Indrit Dedej . Mund të jetë vendosur por emergjenca nuk llogarit mbledhjen e radhës.

Alime Hoxha . Indrit pse nuk e bën kërkesën.


Indrit Dedej . E kam bërë kërkesën në Bashki , do bëjmë shpejt mbledhjen se do iki kryetari me leje, ku e di unë çfarë lejesh merr kryetari se kështu u tha apo jo?

Mukades Gixhari . Jo nuk e di.

Indrit Dedej . Po ti the që do bëjmë mbledhjen më shpejt këtë radhë se kryetari merr leje.

Mukades Gixhari . Absolutisht jo, dëgjo z. Indrit do ta bëjmë mbledhjen se ishte për kreditë e buta që do t'i kalonim që mbledhjen e herës së kaluar z. Ledian i bëri gati dhe tha do t'i kalojmë më shpejt.

Indrit Dedej . Kryetare unë kam bërë një kërkesë për emergjencat.



Mukades Gixhari . Për kërkesën jam në dijeni por ...

Indrit Dedej . Unë nuk shoh asnjë këtu nga ata që kam kërkuar unë. As për ndërtimet pa leje as për zjarret hajt më se nuk ka mbaruar, as për drejtorin e IKMT-së , kështu që unë për vete kot nuk është se...

Hekuran Xhani . Lidhur me vendimin që sapo kaloi Këshilli të marrë listën emër për emër sepse në moment tani ne nuk e votuam problemi qëndron që këta njerëz kanë nevojë taman. Ka njerëz që ndoshta kanë përfituar jashtë kriterëve ne nuk mund t'i prishim punë një njeriu në nevojë se qenka një që nuk e meriton .

Ledian Hasani . Nuk ndahet lista.

Hekuran Xhani . Po tani këshilli thotë ne do vijmë me vendim herën tjetër z. drejtor nga i thati të digjen ulla të njomë. Një person që ndoshta nuk plotëson kriteret këshilli e sheh të arsyeshme e përjashton.

Ledian Hasani . Të gjithë i plotësojnë kriteret.

Indrit Dedej . O Hekri e bëjnë kastile që i sjellin bllok, o votohet o nuk votohet. Silli veç e veç dhe ne i kalojmë.

Ledian Hasani . Si vinka lista tek e tek ai është program nuk është ...

Alime Hoxha . Ne nuk jemi autoriteti që t'i marrim emrat një për një se nuk i verifikojmë dot, atëherë ose merrni përsipër që ti analizoni vetë ato...

Ledian Hasani . I verifikoni dhe hajde bujrum.

Hekuran Xhani . Se kështu i bie që prap dhe radhën tjetër të mos e votojmë dhe të mos e përfitojnë nga tetë , një digjen dhe shtatë tjerë ky është problemi.

Erind Tosku . Nëse kanë futur një pa dokumentacion të ngrihet komisioni t'i shikojë dhe të mbajë përgjegjësi penale këtu në këshill edhe...

Indrit Dedej . Pse do mbajë përgjegjësi penale, këshilli nuk është përgjegjësi penale për atë, ai është në rregull nuk kalon natën e mirë, të vazhdojë me listat tjera.



Enver Memolla . Kjo pikë nuk kaloi vazhdojmë me rendin e ditës.

Mukades Gixhari . Pika 6, miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjen vendore Bashkia Rrogozhinë”. Relaton drejtori i Financës z. Rezart Vogli.

Alime Hoxha . Një sekondë ne në mbledhjen e komisionit të ekonomisë nuk ishte preznt drejtori dhe ne nuk e morëm në shqyrtim, tani nuk e di si ishte punane kemi thënë që nuk do ta kalojmë, nuk do ta marrim në shqyrtim me qenëse në komisionin e ekonomisë nuk ishte prezentë drejtori për të na dhënë sqarime.

Mukades Gixhari . Atëherë nuk do ta dëgjojmë drejtorin që të relatojë.

Silvana Aliu . Përrisa nuk ka dhënë informacion në komision...

Mukades Gixhari . Alime si kryetare e komisionit.

Alime Hoxha . Ne si komision morëm vendimin që të mos kalonte sot për këtë arsye.

Indrit Dedej . Tani të bëhemi çik seriozë.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 8, po pikën 7, Shqyrtim i shkresës së ardhur nga Drejtoria e Financës. Relaton drejtori i Financës z. Rezart Vogli.

Indrit Dedej . Kur nuk është në rregull dyshi se vjen pas kryetarit të bashkisë ai se ka gjithë financën, kur nuk është në rregull ai, ka ikur ajo koha që tallnim...

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me rendin e ditës. Kalojmë në pikën 8, Shqyrtim i informacionit të ardhur nga drejtoria e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik. Relaton Drejtoresha e të ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik znj. Marsida Thartori. Përshëndetje znj. Marsida.

Marsida Thartori . Përshëndetje ! Siç mund të keni parë edhe shkresën ky është niveli i të ardhurave për 6-mujorin e parë është raportuar për detyrat që drejtoria e të ardhurave ka kryer gjatë këtij 6-mujori. Niveli i realizimit të ardhurave është nivle 26 % nga plani vjetor kemi një rritje të ardhurave nga tarifat. Kemi një ulje të ardhurave krahasuar me një vit më parë të hapësirës publike që është plazhet, kishte një ulje që pritej si pasojë e VKM-së. Ndonjë pyetje ndonjë gjë?



Mukades Gixhari . Materialin e keni. Nëse keni ndonjë pyetje. Po z. Indrit.

Indrit Dedej . Unë kam shumë pyetje por nuk dua me e bërë pyetjen se shoh që të ardhurat në plazh e njëjta situatë që kanë qenë bizneset vitin e kaluar e njëjta situatë është që bizneset i shfrytëzojnë prap ato plazhe. Se bashkia tani si ka llogaritur me i mbledhur të ardhurat atyre se nga Ministria nuk ka leje?

Marsida Thartori . Ka një vendim të këshillit të ministrave dhe bashkia vazhdon mbështetet mbi VKM ndërsa për zbatimin e hapësirave publike që ju thonin që janë të lira dhe nuk janë marrë masa nuk është kompetencë e drejtorisë të ardhurave të marrë masa për lirimin e hapësirave [ublike.

Indrit Dedej . Jo dua të them këtë që janë po ato të ardhura sepse ato e shfrytëzojnë.

Marsida Thartori . Ne aktualisht kemi marrë të ardhuranga kontratat që janë aktive dhe që janë...

Indrit Dedej . Sa kontrata janë aktive?

Marsida Thartori . Aktualisht kanë qenë 41 kontrata pesë vjeçare , dy kontrata janë prishur për mospërbushje detyrimesh. 39 kontrata 5 vjeçare që mbyllen në fund të sezonit janë miratuar dhe 4 kontrata të reja për vitin 2025.

Indrit Dedej . Unë di që kanë qenë më shumë.


Marsida Thartori . 41 kanë qenë. Dy janë prishur për mospërbushje të detyrimeve të pagesave të debisë ndër vite.

Indrit Dedej . Atëherë i bie që bashkia nga 80-90 biznese që ka atje ...

Marsida Thartori . Kanë qenë 5 -vjeçare 41 plus të miratuara paraprake që miratoheshin çdo vit, po bashkë me 1-vjeçaret.

Indrit Dedej . Nuk kanë qenë 41 kontrata.

Marsida Thartori . 41 kanë qenë kontrata 5 vjeçare pastaj çfarë ndryshon vit për vit, këtë vit psh nga këta 1-vjeçaret janë miratuar vetëm 4, që i shtohen 39 që janë 5 vjeçare.



Indrit Dedej . Po si zyrë taksash i keni bërë kontrolle bizneseve që janë duke zhvilluar biznes?

Marsida Thartori . Patjetër janë aktualisht inspektorët në terren.

Indrit Dedej . Sa biznese ka që nuk kanë kontrata fare?

Marsida Thartori . Që nuk kanë kontrata plazhesh? Kontratat e plazheve nuk i kontrollojmë ne, ngrihet një grup ndërinstitutional me urdhër të Kryeministrit që përshin AKB-në, Ministrinë e Turizmit përfshin shumë faktorë policinë e shtetit, vetëm një duhet të jetë përgjegjës nga bashkia mesa di ka shkuar policia bashkiake që është paraqitur ku është ngritur komisioni dhe ka dalë në zbatim të urdhërit të Kryeministrit.

Indrit Dedej . Duhet të bëjë kontroll edhe zyra juaj se jeni zyrë të ardhurash.

Marsida Thartori . Nuk është kompetencë e jona. Na vjen me vendim nga Kryeministri. Ne kontrollojmë bizneset kanë NIPT apo nuk kanë, kjo është detyra jonë por nëse ushtron aktivitet shezllonesh në hapësirë publike nuk është kompetencë e taksave.

Indrit Dedej . Kush i ka pas firmosur kontratat për rërën.

Marsida Thartori . Taksat po zbatojmë vendimin , ne thjeshtë zbatojmë vendimet që na vijnë dhe vjelim të ardhurat për atë sipërfaqe që miratohet nga AKB-ja.

Indrit Dedej . Po tjerat?


Marsida Thartori . Si tjerat.

Indrit Dedej . Pa letra kanë ushtruar...

Marsida Thartori . Nuk ka dalë AKB-ja mesa di përgjatë muajit Qershor ka bërë verifikime ka ngritur Task forcën që mbështetet nga policia bashkiake.

Indrit Dedej . Po biznese pa NIPT ka?

Marsida Thartori . Patjetër që ka biznese pa NIPT janë raportuar janë mbajtuar akt konstatime dhe janë dërguar tatimeve.



Enver Memolla . Më shumë e kam në lidhje me debitorët , më ka ardhur një shkresë në emër të gjyshit tim të ndjerë ku i kërkohet të paguajë taksat e pastrim gjelbërimit për vitin 2019-2025 kur ai është i vdekur në 2002- in.

Marsida Thartori . Ja të të shpjegoj ndërtesë ka ty tokë?

Enver Memolla . Ndërtesë nuk ka, jam dakord me tokën flas pastrim gjelbërimit.

Marsida Thartori . Ok se ka një problem , lista e taksave është gjetur një regjistër taksash mbahet një regjistër taksash përditësohet dhe shtohet nga gjendja civile kur vijnë kryefamiljarë të rinj dhe nuk mund të heqim emra nga regjistri i taksave nëse ti nuk vjen dhe bën një vetëdeklarim edhe një NIPT nuk ç'regjistrohet nëse ti nuk bën familjario trashëgimtari mund të bëjë një aplikim për ta ç'regjistruar një NIPT, e njëjta gjë ndodh edhe me taksat nëse një kryefamiljar vdes taksa do trashëgohe. Nëse ti nuk bën një deklarim vullnetar që ky person ka ndërruar jetë dhe i kalon pasardhësit kryefamiljarit në vijim ne nuk mund të heqim dot emra nga regjistri i taksave. Dua një dokumentacion që ta justifikoj pse e kam bërë këtë veprim.

Enver Memolla . Sapo thatë që merrni kryefamiljarë të rinj nga gjendja civile, atëherë kryefamiljari që e ka pasur në atë kohë , ç'regjistrimet e të ndjerëve i bën gjendja civile apo jo?

Marsida Thartori . Po.

Enver Memolla . Kështu që i keni marrë drejtë nga aty.

Marsida Thartori . Po por ligji parashikon që duhet të ketë edhe deklarime vullnetare.

Enver Memolla . Në bazë të ligjit duhet të funksiononi ju pastaj për të sjellë njoftiminjo nga 2002 në 2025 dhe nuk kërkoni nga 2002 por nga 2019-2025, 6 vjet.

Marsida Thartori . Por ndoshta deri në 2018 mund të jenë paguar taksat nga i biri në emër të të atit.

Enver Memolla . Kanë paguar taksat e tokave.

Marsida Thartori . Ok.



Enver Memolla . Po ç'lidhje kanë pastrimi gjelbërimi , ndriçimi se kjo pjesë po has shumë problematikë se ka shumë të ndjerë që i kërkojnë taksat.

Erind Tosku . Të bëhet update i listës së taksave këtë po thotë Veri pak a shumë.

Enver Memolla . Se ka dalë një ligj që kryefamiljari që ka pasur certifikatë familjare në atë kohë tani mbrapa duhet të sjellë dokumente që vërteton vdekësinë atëherë po.

Marsida Thartori . Ja të të them, ndodh që shpesh herë ndërron jetë i ndjeri nuk çelet dëshmia e trashëgimisë ose çelet dhe nuk depozitohet dhe ne nuk marrim dijeni këto trashëgimi janë kaluar nuk janë kaluar dhe taksat dhe tarifat mbeten në emrin e të ndjerit deri në momentin që pasardhësit dhe pasuesit e trashëgimisë ...

Indrit Dedej . Do ikim se unë nuk e shoh të arsyeshme me vazhduar. Shumë faleminderit.

Marsida Thartori . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër për znj. Marsida? Kalojmë tek pika tjetër, kërkesë nga poeti z. Hekuran Dedej. Unë po e lexoj kërkesën. Përsëritet me respekt po ju drejtohem me këtë kërkesë me shpresën që do të kontribuoni në realizimin e kësaj kërkesë për botimin e një libri me poezi i cili i shkon interesit të shoqërisë shqiptare dhe përtej bashkisë tonë, në pasurimin kulturor dhe artistik të vlerave të qytetërimit tonë. Do të jua dija për nder nëse më ndihmoni ta botoj këtë libër me vlerën 500 mijë lekë të vjetra nga buxheti i bashkisë tonë. Tani drejtori i financës që do ja drejtonim pyetjen që i ka mundësitë apo jo nga ana financiare u largua, kështu që do ta lejmë për mbledhjen e radhës.

Jemi tek të ndryshmet z. Hekuran Xhani fjala për ju.


Hekuran Xhani . Për drejtorin e shërbimit social na ka ardhur një kërkesë nga z. Nazmi Saraçi ka një djalë invalid, çfarë u bë me këtë kërkesë?

Ledian Hasani . Nuk ka ardhur shkresa tek unë . Shkresa nuk ka ardhur fare.

Hekuran Xhani . Nuk ka ardhur fare?

Indrit Dedej . O Hekri i bëjmë radhës tjetër bashkë me ullinjtë.

Hekuran Xhani . Tani aty në Lekaj është një familje shumë në nevojë, janë dy pleq me një



banesë të rrënuar Besnik Tafa dy pleq janë ato dhe si është mundësia të ndihmohej të riparohej çatia janë përjashtë dhe këtu nuk kemi marrë informacion se çfarë u bë. Tani këtu duhet të jetë dhe kryetari i bashkisë.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua dhe z. Shpati Kolgega, znj. Fatmira Thartori.

Hekuran Xhani . Kujt t'i drejtohem tani nga bashkia se këto janë kërkesa që janë diskutuar dhe mbledhjen e kaluar, si me amrrë përgjigje në lidhje me zgjidhjen e problematikës.

Elton Xhani . Sa i përket pjesës së vreshtave më duket është kaluar njëherë.

Mukades Gixhari . Është kaluar si kërkesë duhet projektvendim.

Hekuran Xhani . Edhe këtë familjen e kemi kaluar por fakti po vjen dimri prap edhe ai përballet me vështirësitë e dimrit.

Indrit Dedej . Shefi financave iku nuk vjen në komision o Hekri, e kupton çfarë ndodh apo jo? Ok po a ke projektvendim çfarë bën muhabet kot, iku pra ai ato po e bëjnë sikur me e pasur pronë. A e kemi kaluar pse nuk e ka sjellë.

Hekuran Xhani . Kujt t'i drejtohem tani se përderisa sa këtu nuk ka një përfaqësues.

Indrit Dedej . U bë komisioni dje për PBA-në nuk erdhi kur nuk vjen ai çfarë të bëjmë ne.


Mukades Gixhari . Ka ardhur si kërkesë ne e kemi mbështetur .

Ledian Hasani . Për çfarë problematike është se mbështetje financiare nuk mund t'i japim çdo personi, nuk mund të digjet rrushi dhe të hyjë zyra ime në lojë.

Hekuran Xhani . Nuk t'u drejtova ty Ledio për rrushin , t'u drejtova për këtë personin me aftësi tyë kufizuar e dyta ky Besnik Tafa është miratuar fondi ka dy vjet që kur kanë kaluar këto 17 familjet në nevojë nuk është vënë dorë janë dy pleq vetëm.

Mukades Gixhari . 9 milion e ka.

Hekuran Xhani . Riparim çatie e ka.



Ledian Hasani . Ja të lidhem me firmën. Ku është ky në Luz?

Hekuran Xhani . Në Lekaj.

Ledian Hasani . Po kam shkuar dhe unë tek shtëpia e tij.

Mukades Gixhari . Derisa Ledio të na japë informacion keni ndonjë? Po z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Kam disa gjëra meqenëse kam drejtorin e bujqësisë do i bëj nga dy petje se ne kemi miratuar që pjesa e vadijes do jetë zero lekë për pjesën e ngritjes mekanike dhe 100 lekë të reja për dynym për rrjedhje të lirë. Ka punësuar bashkia për pjesën e Rrogozhinës pjesën poshtë për kontrollimin e lëvizjeve të ujit?

Elton Xhani . Po vetëm një punëtor është për pjesën e Rrogozhinës.

Enver Memolla . Është i bashkisë?

Elton Xhani . Po.

Enver Memolla . Bordi ka?

Elton Xhani . Bordi ka vetëm pjesën e portave.

Enver Memolla . Tani kush e menaxhon portën, bordi apo bashkia?

Elton Xhani . Atëherë duke parë situatën se është tepër thatësirë e madhe ...

Enver Memolla . Tani kush e menaxhon pyeta.

Elton Xhani . Niveli i ujit nuk është siç ka qenë vitet e tjera.

Enver Memolla . Elton mos më dil tek pika e fundit, nisim tek pika e parë kush i menaxhon portat, bordi?

Hekuran Xhani . Bordi kullimit ka përgjegjësi për portat.

Elton Xhani . Bordi ka përgjegjësi për portat.



Hekuran Xhani . Kam punuar 8 vjet atje me Ver Bykun, kanali Peqin- Kavajë dhe pritaf që ndodhen në Peqin-Kavajë janë të bordit.

Enver Memolla . Do dal diku tjetër, atëherë drejtoria e bujqësisë me punëtorin që ka në Rrogozhinë për çfarë është?

Hekuran Xhani . Për të administruar ujin nga kanali i parë në kanal të dytë dhe parcelë.

Enver Memolla . Që do të thotë punëtori juaj në moment që konstaton një prizë të mbyllur duhet të merrni ju bordin e kullimit.

Elton Xhani . Po.

Enver Memolla . Ka ndodhur kjo pjesë?

Elton Xhani . Më ke vënë ti në dijeni mua dhe nuk kam marrë masë?

Enver Memolla . Po flas për punëtorin, jo për dijeni.

Elton Xhani . Punëtori mund të ketë qenë për momentin aty...

Indrit Dedej . O shoku Enver ke gjë për djegiet? Kemi situatë emergjente...

Enver Memolla . Më ler ta mbaroj, tani unë di që ai punëtori duhet të bëjë kontrollin për mirë menaxhimin e ujit që do të thotë në moment që punëtori survejon në terren që kjo prizë nuk ka më për të vaditur duhet të vejë në dijeni bordin ta mbylli. Bordin e mbyll pa dijeninë tuaj dhe fermerët i lejnë në vapë, kjo gjë po cedon shumë .

Elton Xhani . Duke marrë shkas nga këto shqetësime se nuk është vetëm këtu në Rrogozhinë ky problem është nga Sinaballaj deri në Lekaj duke marrë shkas nga kjo situatë unë bashkë me nënkryetarin ishim në një mbledhje dhe me bordin që duke parë situatën do jetë tre ditë uji do shkojë në Bashkinë e Kavajës tre ditë do rrijë këtu. Kemi vendosur dhe njerëz kemi punësuar tani vetëm me ruajtur portat se punëtori sa kthen kurvizin Veri shkon e hap portën dhe nuk ka faj punëtori aty nuk është se... kemi 25 porta.

Erind Tosku . Bëni një çelës që ta keni vetëm ju, jo të vijë tjetri me çelës papagall dhe ta hapi.



Enver Memolla . Duhet të dimë diçka dhe Eltoni e di shumë mirë kjo pritë ka kuotën e vet të shkarkimit apo jo? Nuk mund ta lesh portën e lirë ti ose ta bllokosh zero në moment që ti lërë portën minimale të rrjedhi dhe të vazhdojë ... nuk po të bëj debat po ngre shqetësimin . I keni marrë masat këto tre ditë që tjetri ka një emergjencë poshtë për të vaditur ? Se këtu doja të dilja.

Elton Xhani . Ka dy ditë që i kam lajmëruar, kam lajmëruar dhe administratorët.

Indrit Dedej . Do kërkojsh ndonjë emergjencë Prefekti të vijë këtu më del mua Prefekti bën reklamë atje. Ku është ai shefi ai bukuroshi i policisë së asaj dy makina të vjetra që ka i mbante tek prona kryetarit kurse tek rruga e re u dogjën komplet ullinjtë, flasim siç është për të folur kam fakte kam qenë në terren. U mblodhën si bukurosha këtu kur u dogjën shinat. Kam qenë 4 ditë në terren pas 4 ditësh ka ardhur helikopteri. U dogjën shinat dhe erdhi helikopteri se aq e keni se nuk jua mbante me marrë në telefon, është bërë rruga e re zjarrfikëset nuk u ngjiten që kanë djegur parcelat buzë rruge.

Mukades Gixhari . Z. Indrit ta mbaronte njëherë z. Enver.

Indrit Dedej . Ta mbaronte, do gjej rojet e Verit unë kush roja ku fshihet roja është turp. Kush ma paguan dëmin mua është turp. Për çfarë je ti për të siguruar ullinjtë apo për të mbrojtur territorin je për të mbrojtur territorin

Enver Memolla . Tani kemi miratuar një fond emergjence në buxhetin e 2025 nga raportimi që na është bërë dhe nga ana e zjarrfikëses mund të përdoret ky fond për të blerë një zjarrfikëse të re? Ku mund të jetë dhe pak nevoja për të ngjitur atë rrugën lart .

Erind Tosku . E bëmë pyetjen kur ishte shefi i MZSH-së këtu, Veri po i sorollatemi muhabetëve kanalet rrugët nuk kalonin edhe unë isha kur ra zjarri që desh erdhi këtu tek shtëpia në Sinaballaj kodrat e gjithë gjërat tjera po nuk ishin helikopterat këtu do kishte marrë përmasa jashtë mase. Se tani do kujtohem ne pasi u dogjën gjithë ullinjtë. Pse nuk morëm masa duhet të merren masa kur bie zjarrika ferra për të prerë.

Indrit Dedej . Nuk fiket zjarri me shufra, punëtorët e zjarrfikëses në zjarrme bombul makinash.

Hekuran Xhani . Veri ka të drejtë se u dogjën këtë vit por vera do vijë dhe vitin tjetër.

Erind Tosku . O xha Hekër edhe vjet u-dogjën edhe parvjet u dogjën.



Hekuran Xhani . Zjarrfikëse të vitit 1968 e di unë por Indriti më tha 1963 nuk përballohet këto situata zjarri aq më keq si ky vit. Tani në mbështetje të diskutimit të Verit që ai fondi i emergjencave të shkojë për të blerë një zjarrfikëse të re për bashkinë Rrogozhinë...

Erind Tosku . Po se ta kam thënë nuk është për atë e ke dhe tek Këshilli Bashkiak radhës që shkoi nuk ka kaluar ti mezi bleve një skrep, me fondin e emergjencës mezi bleve një skrep o xha Hekër.

Hekuran Xhani . Tani me fondin e emergjencës të blejmë zjarrfikëse pra.

Erind Tosku . Edhe vjet ra zjarri prap.

Hekuran Xhani . Tani duhet t'i japim një zgjidhje këtij problemi ne?

Erind Tosku . Ku e ke?

Hekuran Xhani . Fondi i emergjencave i këtij viti me shkuar me blerë një zjarrfikëse.

Erind Tosku . 10 hektarë u dogjën.

Hekuran Xhani . Tani marrim masa që të mos digjen vitin tjetër këto që u dogjën nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Tani unë kisha diçka meqë mora fjalën dhe për drejtorin e bujqësisë. Tani situata është kritike për të gjithë rrethin Kavajë dhe sigurim kryesor kanali Peqin-Kavajë, tani duhet një mirëkordinim ndërmjet punonjësve të bashkisë dhe punonjësve të bordit të kullimit sepse punonjësit tanë shkojnë e hapin vijnë rojet e bordit dhe e mbyllin . Tani me çuar ujin në Zhabjak po e mbylle këtu nuk bëhet se njëri e hap njëri e mbyll shkon uji prap në parcelë , efektiviteti i vaditjes është zero. Duhet një mirëkordinim punonjësit e bashkisë me rojet e bordit.

Elton Xhani . Për atë pjesë ishim dje dhe me rojet e bordit dhe ramë dakord që tre ditë do e mbajë Bashkia e Kavajës dhe do mbylli portat, tre ditë do vijë uji këtu tek ne ...

Hekuran Xhani . Keni bërë një grafik ju te xhaji që ta dinë qytetarët ...

Elton Xhani . Nga nesër do mbyllet kam lajmëruar edhe kryepieqtë që të lajmërojnë fermerët.

Hekuran Xhani . Pra Bashkia Rrogozhinë nesër do ketë ujë .



Elton Xhani . Po deri ditën e premte, të mërkurë, të enjte, të premte pastaj të shtunën e kap Kavaja, Luzi i Vogël.

Erind Tosku . Të shtunë, të dielë, të hënë e ka Rrogozhina pjesën e vaditjes.

Elton Xhani . Duke parë në qoftë se do ketë prurje se ishall do Zoti bien dhe shi, do hapet ...

Hekuran Xhani . Hapet gjithë andej ajo pastaj po ra shi.

Erind Tosku . T'i njoftojmë ditët se kushdo tani ka mundësi ta shohë dhe online mbledhjen e këshillit.

Elton Xhani . Do rrijë mbyll për tre ditë pastaj do hapet.

Fatmira Thartori . Në cilët ditë pra?

Elton Xhani . Bashkia Rrogozhinë është e gjitha.

Hekuran Xhani . Tani edhe një pyetje tjetër në lidhje me këto djegiet që janë bërë. A mund t'i vijmë në ndihmë ne si bashki dhe këshill bashkiak të paktën jo 100% kompensimin e dëmit që është krijuar të paktën ullinjtë.

Elton Xhani . Kam bërë gati shkresën do ja çoj njërive aty kanë të gjithë agronom të shkojnë të verifikojnë sa është dëmi pastaj ne buxhet për emergjencë nuk kemi .


Hekuran Xhani . T'i drejtohem dhe Ministrisë së Bujqësisë ndoshta dhe ato me një fond mund të na ndihmojnë se gjynah, atij i janë djegur 80 rrënjë ullinj .

Elton Xhani . Rruga ligjore për t'i dhënë të ardhura fermerit, ullinjtë duhet të jenë të siguruar asnjëri nga ne nuk i ka të siguruar.

Indrit Dedej . I ke djegur pyjet o shkou.'

Hekuran Xhani . Ne nuk kemi siguruar njerëzit.

Indrit Dedej . Ka marrë tjetri firmën paguan 3 milion euro për të mbrojtur pemën , kush i paguan ato pisha që kanë 50 vjet që mezi janë ruajtur e mban ti përgjegjësinë o shoku nuk mban , duhet të shkosh ti në burg.



Elton Xhani . Nuk e mbaj unë përgjegjësinë .

Indrit Dedej . Sepse skrepi jot punon privatisht nuk hap as rrugë as trashë asgjë, ti ai drejtori i bujqësisë që nuk vjen hiç ai i pyjeve ai Kaja, po pra duhet të mbash përgjegjësi.

Hekuran Xhani . Elton problemi qëndron ...

Indrit Dedej . Se ti e di kush e ka vënë flakën e zjarrit e ka vënë OSHE -ja , ka rënë 4 herë me një vend. Shko ti si bashki procedoje.

Hekuran Xhani . Pak a shumë në një linjë jeni, detyra e drejtorisë së bujqësisë është të evidentojë çdo lloj djegie edhe të raportohet edhe këshillit sa është dëmi i shkaktuar nga zjarri për vitin 2025. Njëkohësisht i drejtohet edhe pushtetit qëndror për dëmet sepse këto janë katastrofa që ndodhin në gjithë botën nuk ndodh zjarri vetëm në Rrogozhinë. Përpiqemi t'i japim një zgjidhje sa më të mundshme fermerëve ky është problemi prandaj kemi të paktën një dëm kolateral të protokolluar që kaq në bashkinë Rrogozhinë . Periudha e zjarreve 2025 goditi 2000 rrënjë ullinj, nga këto Indriti 5 ky, 10 .. të paktën të kemi dhe pastaj t'i bëjmë me kërkesa të paktën t'i vijmë sa t'i vijmë në ndihmë se atij i janë djegur 100 rrënjë ullinj . Dhe nuk janë ullinj që janë mbjellë këtë vit se ai pale sa ka shpenzuar që e ka bërë 10 vjeç ullirin. Kështu që dhe njësitë administrative, kanë specialist bujqësie çdo njësi administrative të shkojë të verifikojë në terren edhe t'i vijë këshillit një informacion në lidhje me dëmet e shkaktuara. Faleminderit.

Fatmira Thartori . Skrepi ku është?

Elton Xhani . Skrepi është në Gërmenj, ka shkuar dje.


Fatmira Thartori . Para Gërmenjit ku ka qenë?

Elton Xhani . Ka qenë në Lekaj. Mund të dalësh në terren të shohësh.

Fatmira Thartori . Ka qenë në Gërmenj për hapjen e kanaleve .

Elton Xhani . Është çuar dje në darkë në Gërmenj.

Fatmira Thartori . Për periudhën që ranë zjarret nuk mund t'u merrte ky skrep që të hapte rrugën apo të pengonte përhapjen e zjarreve sepse atje është urgjenca nuk është vetëm bujqësia emergjencë në momentin që ishte urgjenca në male apo në territore që ishin më problematikë .



Të merret ky skrep dhe të shkonte atje ose dhe mund të merrnin skrepa të bashkisë këtu afër dhe të hapej rruga për zjarrfikësen duhet të bëheshin këto gjëra. Edhe kur e panë ato zotërinjtë atë ditë ky ishte problemi kryesor të hapeshin trashetë të hapeshin rrugët.

Hekuran Xhani . Ai skrepi është me zinxhirë ai nuk është për atë tokë.

Indrit Dedej . Ka shkuar zjarrfikësja kur është fikur zjarri, nga aty nuk dinte ku të shkonte ai doli tek Kalemte nuk kishte ku shkonte më.

Fatmira Thartori . Këtë pra po them të hapin rrugë.

Indrit Dedej . Shihe është djegur me hektarë këtu buzë rruge, rruga e re që çon në Thartor rruga e re.

Elton Xhani . Ne po ngrejmë një shqetësim por nuk janë të gjitha të bujqësisë.

Indrit Dedej . Shihe tensioni 6 mijëshështë e treta herë që djeg atje , ka pasur më shumë njerëz e kanë mbërthyer më shpejt tani nuk ka njerëz nuk shkon njeri në ndihmë, ja shihe tensioni 6 mijësh i ka bërë 4 herë xhestin flakën pyllit apo çfarë ka zaptuar. Tani pse mos merret një masë të shkojë dikush e të thotë o shoku ju OSHE-ja çfarë pune bën ti, se këto janë me vendim qeverie që 6 mijëshet tensioni lartë mbrohen ku e di unë me ligj të veçantë . Ka shkuar kryeplaku mbi 10 herë është ankuare kanë parë pak të zi më fal për shprehjen dhe se kanë përfillur.

Elton Xhani . Ju si këshill...


Indrit Dedej . Qysh si këshill pse ne do mbrohemi si këshill , ne ju kërkojmë llogari ju, se nuk paguhemi nga ju.

Erind Tosku . Kemi gjetur Eltonin jemi drejtuar të gjithë atij.

Indrit Dedej . Po mirë po të ishte nënkryetari po të ishte kryetari ja tregoja unë.

Erind Tosku . Për gjëra që nuk i takojnë atij se po e bëjmë si tabelë qitjeje.

Indrit Dedej . E di sa ndërtime pa leje ke? Do t'i jap me emra, vijnë marrin lekë këto dhe taksa bashkia nuk ka , po çfarë ku janë investimet . Do ti jap me emra.Ku është drejtori ky i IKMT-së? Nuk vijnë dy herë ka ardhur kryetari i bashkisë vjen kur ka buxhetrruan ndonjë lek me atë çikën e vogël edhe thotë...



Erind Tosku . Për këtë nuk kam informacion.

Indrit Dedej . Unë kam 20 e ca vjet që kam mbjellë ullinjtë të digjen ullinjtë 5 mijë vjeçar kot e më kot digjen se nuk kishte asnjë lloj force aty kaloj edhe zjarrfikësja vinte aty...

Elton Xhani . Ka qenë i përmasave të mëdha zjarri.

Silvana Aliu . Ore nuk ka mbaruar vera, flisni për verën tjetër.

Indrit Dedej . Administratorin e gjeta duke ardhur bashkë me 5 veta ka një administrator po vinte si bandi përpjetë. Ku po shkon i thashë? Ku është zjarri tha?- Ka ikur zjarri i thashë u fik.

Silvana Aliu . Nuk shkonka zjarrfikësja po ra në Gosë as zjarrfikëse nuk kishte as nuk u duk njeri.

Indrit Dedej . Kryetare po e mbyll tani më bëhet qejfi se unë ndoshta nuk jam i juaji por më bëhet qejfi për atë kryeministër që po i shkund njëherë prej leckash se është mbushur vetëm me injorantë me budallenj, më bëhet qejfi.

Hekuran Xhani . Është detyra e kryeministrit Indrit mos na çoj larg.

Indrit Dedej . Ai duhet ta kishte pas bërë nuk është bërë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër? Meqë nuk keni pyetje diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 11 : 10⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 57 min ; 15 sek.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 28 (njëzet e tetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

**Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**